

IMYB 2016 – Test /SHQIP/

- 1. Çfarë përqindjeje zë përafërsisht uji në mjaltë?**
 - a. 18 %
 - b. 25 %
 - c. 12 %
- 2. Çfarë temperature ka në brendësi të korpusit pjellës?**
 - a. 22 °C
 - b. 28 °C
 - c. 35 °C
- 3. Si quhet gjëndra, lëngu i së cilës i shërben bletës për t'u orientuar?**
 - a. Gjëndra e Nasonovit
 - b. Gjëndra alkalike
 - c. Gjëndra hipofaringale
- 4. Çfarë është varroa?**
 - a. sëmundje mikotike
 - b. virus
 - c. parazit
- 5. Çfarë dobie ka pjalmi për bletët?**
 - a. është burim i proteinave
 - b. është burim i karbohidrateve
 - c. përdoret për ndërtim të hojeve
- 6. Përse përdorimi i antibiotikëve te bletët nuk është i rekomandueshëm?**
 - a. sepse bletët janë alergjike ndaj antibiotikëve
 - b. sepse bletarët mund të jenë alergjikë ndaj antibiotikëve
 - c. sepse ka rrezik të hyjnë antibiotikët në zinxhirin ushqimor
- 7. Ku e marrin bletët propolisin?**
 - a. në gjethe
 - b. në burbuqe
 - c. në lule
- 8. Për çfarë e përdorin bletët propolisin?**
 - a. për çimentim dhe dezinfektim
 - b. si ushqim për larva
 - c. për prodhim të peltes mbretërore
- 9. Për çfarë përdorin bletarët acidin thnegëlor?**
 - a. për të dezinfektuar kornizat
 - b. për të luftuar tenjën e bletëve
 - c. për të trajtuar varroan
- 10. Sa ditë zgjat zhvillimi i amës (nga faza e vezës deri në fazën e bletës së rritur)?**
 - a. 16 ditë
 - b. 21 ditë
 - c. 24 ditë
- 11. Cila bletë lëshon më shumë vezë në qelizat?**
 - a. ama e vjetër
 - b. ama e re
 - c. mashkulli
- 12. Sa spermatozoidë ka ama e re në spermatekë?**
 - a. 2 miliona
 - b. 6 miliona
 - c. 1 milion

- 13. Sa vezë mund të lëshojë ama gjatë një dite?**
- 1 500 vezë
 - 500 vezë
 - 750 vezë
- 14. Sa sy kanë bletët?**
- 5 sy
 - 6 sy
 - 2 sy
- 15. Çfarë bën bleta menjëherë pas lindjes?**
- konsumon mjaltin dhe rritet
 - del nga zgjoi dhe kërkon burime të mjaltit (kullota)
 - pastron qëllizën ku ka lindur
- 16. Çfarë ngjyre ka lëngu i trupit (limfa) të bletës?**
- të kuqe
 - të bardhë
 - të pangjyrë
- 17. Ku ndodhet mjalti në zgjua?**
- në kornizën nën pjellë
 - mbi pjellë
 - brenda korpusit pjellës
 - përpara korpusit pjellës
- 18. Sa bleta ka në një kilogram?**
- 32 000 bleta
 - 24 000 bleta
 - 17 000 bleta
 - 11 000 bleta
- 19. Si quhet asociacioni ndërkombëtar i bletarëve?**
- FIS
 - FIFA
 - IOC
 - Apimondia
- 20. Çfarë nuk prodhojnë bletët?**
- mjaltë
 - dyllë
 - nektar
 - helm
- 21. Në cilën mbifamilje të insekteve bëjnë pjesë bletët?**
- Hymenoptera
 - Apidoptera
 - Apidae
 - Lepidoptera
- 22. Pika e shkrirjes së dyllit të bletës është:**
- 46 °C
 - 64 °C
 - 76 °C
 - 84 °C

- 23. Bletët që gjenden në pemë quhen:**
- top
 - luzmë
 - grup
- 24. Cila bletë nuk vdes pas shkëputjes së thumbit?**
- ama
 - mashkulli
 - bleta punëtore
- 25. Çfarë është partenogjeneza?**
- riprodhimi nga vezët e pllenuara
 - riprodhimi nga vezët jo të pllenuara
 - riprodhimi nga vezët e pllenuara dhe jo të pllenuara
- 26. Kur bletët prodhojnë sasinë më të madhe të dyllit?**
- nga dita e 5-të deri në ditën 11-të të jetës së bletës
 - nga dita e 3-të deri në ditën 9-të të jetës së bletës
 - nga dita e 10-të deri në ditën e 16-të të jetës së bletës
- 27. Çfarë ngjyre kanë meshkujt e Varroa destruktur?**
- kafe
 - të zezë
 - gri dhe të bardhë
- 28. Cili organ i bletës sulmohet nga nosema?**
- skeleti i jashtëm
 - trakti tretës
 - sistemi nervor
- 29. Në çfarë temperature të jashtme lirohet grumbulli dimëror i bletëve dhe ato fillojnë të mbledhin pjalmin dhe nektarin?**
- 6 °C
 - 12 °C
 - 19 °C
- 30. Bletët mbledhin pjalmin. Në cilën pjesë të lules gjendet pjalmi?**
- stigmë
 - nënpetla
 - pistil
 - thek